

Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal
Pasqyrat Financiare
për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2019
(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

Raporti i audituesve të pavarur	i-iii
Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2019:	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim/humbjeve dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto për mbajtësit e kuotave	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	5-26

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Administrues të Shoqërisë “SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.,
Shoqëri Administruese e Fondëve të Pensionit.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Fondit të Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA” (“Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto të fondit të investimit për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Investimit më datë 31 dhjetor 2019, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Fondi i Investimeve në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Fondit të Investimit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra financiare më datë 26 qershor 2019.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit të Investimeve për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin e Investimeve ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit të Investimeve.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të Fondit të Investimeve.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.



Grant Thornton Sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

1 qershor 2020

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"
 (të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)


Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	10	36,831,170	31,210,135
Investime në letra me vlerë	11	1,275,446,643	1,038,282,500
Interes i përlogaritur	12	24,787,855	20,082,565
TOTALI I AKTIVEVE		1,337,065,668	1,089,575,200
DETYRIME			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		3,350,908	2,752,473
Të pagueshme për pensionet ose tërheqjet e parakohshme		681,826	1,177,004
DETYRIME (Përjashtuar aktivet neto që i atribuohen mbajtëseve të kuotave)		4,032,734	(3,929,477)
VLERA E AKTIVEVE NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE		1,333,032,933	1,085,645,723
Numri i kuotave		920,026	778,699
Vlera e aktiveve neto për kuote		1,448.9078	1,394.1791

Këto pasqyra financiare të Fondit i Pensionit Vullnetar SIGAL janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese të Fondit, Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a., më qershor 2020 dhe janë firmosur nga:


 Naim Hasa
 Administrator




 Junida Zavatani
 Drejtore e Financës

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"*(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat	12	76,137,772	66,470,611
Totali i të ardhurave		76,137,772	66,470,611
Shpenzime për tarifë administrimi		(35,896,111)	(29,543,608)
Humbje neto nga kursi i këmbimit		-	(843,205)
Rimarrje/(Zhvlerësime) në letra me vlerë		5,217,500	(5,217,500)
Totali i të ardhurave		45,459,162	35,604,313
Rritja ne aktivet neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave nga operacionet		45,459,162	30,866,298

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"*(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto për mbajtësit e kuotave më 31 dhjetor 2019**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimet neto nga investimet	45,459,162	30,866,298
Rritja në aktivet neto nga aktivitetet operative	45,459,162	30,866,298
Flukset hyrëse nga anëtarët e fondit	261,326,363	235,579,550
Flukset dalëse prej ndryshimit të fondit të pensionit	(59,398,315)	(56,079,527)
Rritje neto në aktivet neto nga transaksionet me anëtarët e fondit	201,928,048	179,500,023
Rritja totale në aktivet neto	247,387,210	210,366,321
AKTIVET NETO		
Në fillim të periudhës	1,085,645,723	875,279,402
Në fund të periudhës	1,333,032,933	1,085,645,723
Numri i kuotave në fillim të periudhës	778,699	648,164
Kuota të pensionit të emetuara mbi bazën e hyrjeve të kontributeve	183,104	171,291
Kuota të pensionit të tërhequra	(41,777)	(40,756)
Numri i kuotave në fund të periudhës	920,026	778,699

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"*(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset monetare nga aktiviteti operacional		
Të ardhura neto	45,459,162	30,866,298
Rregullime për:		
Të ardhura nga interesat	(76,137,772)	(66,470,611)
Zhvlerësimi/(Rimarrja) i letrave me vlerë	(5,217,500)	5,217,500
	(35,896,111)	(30,386,813)
Rregullimet për zërat jo-monetarë:		
Detyrime ndaj Shoqërisë Administruese	598,435	556,027
Të pagueshme për pagesa pensioni dhe tërheqje te parakohëshme	(495,178)	1,177,004
	103,257	1,733,031
Interesi i marrë		
Flukset monetare neto nga aktiviteti operacional	71,432,483	45,528,662
	71,535,741	47,261,693
Flukset monetare nga aktiviteti investues		
Investime në letra me vlerë		
Flukset monetare neto nga aktiviteti investues	(231,946,643)	(209,308,451)
	(231,946,643)	(209,308,451)
Flukset monetare nga aktiviteti financues		
Flukset hyrëse nga anëtarët e fondit	261,326,363	235,579,550
Flukset dalëse prej ndryshimit të fondit të pensionit	(59,398,315)	(56,079,527)
Flukset monetare neto nga aktiviteti financues	201,928,048	179,500,023
(Ulje)/Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	5,621,035	(12,933,548)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	31,210,135	44,143,683
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës	36,831,170	31,210,135

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal ("Fondi") është një fond kontribuesh i aprovuar për të operuar si i tillë, sipas vendimit nr. 51, datë 30 Mars 2011 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF").

Aktiviteti Kryesor

Objektivi i Fondit është të gjenerojë rritje afatmesme dhe afatgjatë të rëndësishme të kapitalit dhe ka si synim të arrijë këtë objektivi duke tregtuar një portofol të letrave me vlerë qeveritare të qeverisë shqiptare. Fondi është nën administrimin e "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a." ("Shoqëria Administruese"), liçensuar nga AMF më 30 Mars 2011.

Fondi i pensionit bashkë-zotërohet nga të gjithë kontribuesit e fondit, nën një bashkëpronësi të ndarë, që përfaqësohet në kuota të fondit të pensionit. Çdo kuotë përfaqëson pronësinë proporcionale mbi aktivet e fondit të pensionit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare caktoi dhe aprovoi Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. si Depozitar të Fondit të Pensionit. Me pare, Tirana Bank sh.a ishte ne rolin e Depositarit te Fondit. Shoqëria Administruese dhe Depozitari kërkohet të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e Fondit të Pensionit prej aktiveve, veprimeve dhe regjistrimeve të tyre. Për këtë arsye regjistrimet kontabël të Fondit të Pensionit dhe Shoqërisë Administruese mbahen të ndara dhe pasqyrat financiare respektive përgatiten gjithashtu të ndara.

Adresa e regjistruar

Zyra qendrore e Shoqërisë Administruese është në: "Donika Kastrioti", pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.1 Paraqitja e pasqyrave financiare

Parimi i vijimesisë - Ecuria e asetëve të fondit dhe kthimi nga investimi

Sipas raportimit nga Depozitari për tremujorin e parë të vitit 2020, vlera neto e asetëve të fondit të pensionit është rritur me 5,44% krahasuar me vlerën më 31 dhjetor 2019, ndërsa numri i kuotave është rritur përkatësisht me 3,58%, duke shënuar kështu një përmirësim të balancave të fondit. Gjatë periudhës mars-maj 2020, rritja ka vijuar me rreth 2% për vlerën e aktiveve neto dhe kuotave. Cmimi për kuotë është rritur me 0,41% deri në maj 2020. Referuar investimeve të lidhura me fondin e pensionit, struktura e investimeve përbëhet nga instrumente të mbajtura deri në maturim HTM, ndaj ndikimi nga yield në treg ka qënë i ulët.

Ecuria e likuiditetit

Sipas raportimit për tremujorin e parë të vitit 2020 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, rezerva e likuiditetit (niveli i kërkuar i Asetëve Likuide me Cilësi të Lartë ALCL) është më e lartë krahasuar me vlerën më të lartë midis 10% të vlerës neto të asetëve të fondit dhe vlerës së tërheqjeve tremujore për periudhën e raportimit. Në këto kushte fondi është mbi limitet e nevojshme të likuiditetit sipas kërkesave të rregullores për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve, duke qënë e aftë për të përmbushur kërkesat për shlyerje, detyrimet ligjore dhe detyrimet e tjera kundrejt imazhit të investitorëve.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

2. Baza e kontabilitetit (vazhdim)

2.1 Paraqitja e pasqyrave financiare (vazhdim)

Analiza e ecurisë së veprimtarisë

Shoqëria kryen cdo vit analizën e ecurisë së veprimtarisë krahas planifikimit strategjik për një periudhë të paktën 2 vjetare, e cila vlerëson gjendjen e fondit të pensionit kundrejt tregut në terma sasiorë dhe cilësorë.

Në baze të analizës së kryer mbi të dhënat e raportuara pranë AMF më 31 dhjetor 2019 dhe 31 mars 2020, vlerësohet se fondi mund të arrijë të përballojë veshtirësitë e tregut, duke qënë në përputhje me kufizimet rregullatore në lidhur me likuidimet brenda afatit ligjor. Përkatësisht, efekti i rritjes / uljes paralele të kurbës së yield-eve me 100 bp për portofolin e titujve, si faktori kryesor që ndikon në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me të ardhura fikse, do të rriste / ulte vlerën neto të aktiveve të Fondit për 64,685 mijë Lek, e cila nuk ndikon në aftësitë e fondit për të përmbushur kërkesat rregullatore.

Bazuar në analizat e kryera, Drejtimi ka siguri të mjaftueshme se nuk ekzistojnë pasiguri materiale, që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Fondit për të operuar sipas parimit të vijimësisë në të ardhmen e parashikuar. Për këtë arsye, përgatitja e pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë konsiderohet e përshtatshme më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

3. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e fondit.

4. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

5. Vlerësime dhe gjykime kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Fondit të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet.

Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospektive.

A. Gjykime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kane efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimin 7(a) – njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat njihen përgjatë kohës apo në një moment të caktuar në kohë.

5. Vlerësime dhe gjykime kontabël (vazhdim)

B. Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 8.2 – zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen;
- Shënimi 13: njohja dhe matja e detyrimeve të kushtëzuara: vlerësimet kryesore për mundësinë dhe sasinë flukseve dalëse të burimeve

6. Ndryshimet në politikat kontabël

6.1 Standardet e reja të miratuara në 2019

6.1.1 SNRF 16 "Qiratë"

Shoqëria ka miratuar prononcimet e reja të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive këtë vit, si më poshtë: SNRF 16 'Qiratë' SNRF 16 'Qiratë' zëvendëson SNK 17 ' Qiratë ' së bashku me tre interpretime (KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira ', SIC 15' Qiraja Operative 'dhe SIC 27' Vlerësimi i thelbit të Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qiradhënies').

Miratimi i këtij Standardi të ri ka bërë që Shoqëria të njohë një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë të zyrave. Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive. Sipas kësaj qasjeje, Shoqëria ka matur detyrimin e qirasë në vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, duke zbritur e duke përdorur normat në sektorin e qiradhënies për aktive të ngjashme dhe e drejta për të përdorur aktivin është njohur në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, të rregulluar nga shumata e çdo pagese të parapaguar ose të llogaritur të qirasë në lidhje me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar.

Për kontratat e qirave të lidhura në datën e aplikimit fillestar të standardit që nuk plotësojnë kushtet e klasifikimit si qira financiare sipas kërkesave të SNRF 16, Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë përkufizimin e qirasë nga SNK 17 dhe KIRFN 4 .

Shoqëria ka zgjedhur të mos përfshijë kostot fillestare direkte në matjen e së drejtës së përdorimit të aktivitetit për qiratë operative ekzistuese në datën e aplikimit fillestar të SNRF 16, e cila është 1 janar 2019.

Në vend që të kryejë një rishikim të zhvlerësimit në aktivet e së drejtës së përdorimit në datën e aplikimit fillestar, Shoqëria është mbështetur në vlerësimin e saj historik nëse qiratë kanë qenë menjëherë të mëdha përpara datës së aplikimit fillestar të SNRF 16. Norma mesatare e ponderuar e huamarrjes në rritje e aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 1,5% p.a.

6.1.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Standardet dhe ndryshimet që nuk janë akoma efektive dhe nuk janë miratuar në fillim nga Shoqëria përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve
- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit.

7. Permbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit aktual në fund të vitit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të matur me vlerën e drejtë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit përgjithësisht njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(b) Interesi

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivitet ose detyrimit financiar deri në:

- vlerën kontabël bruto të aktivitet financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Në përlllogaritjen e normës efektive të interesit, për instrumente financiare të ndryshëm me kredit të zhvlerësuar, Fondi vlerëson flukset monetare të ardhshme duke konsideruar gjithë kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, me përjashtim të humbjeve të ardhshme që rrjedhin nga rreziku i kredisë. Për aktivitet financiare me kredit të zhvlerësuar, Fondi llogarit normën e interesit efektiv të rregulluar të kreditit duke përdorur flukset monetare të ardhshme të vlerësuara që përfshijnë edhe humbjet e pritshme të kredisë. Përlllogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksioneve dhe tarifat e paguara ose të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

Kosto e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim dhe për aktivitet financiare, rregulluar për çdo zhvlerësim nga humbjet e pritshme të kredisë.

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar është kostoja e amortizuar e aktivitet financiar përpara zbritjes së provizionit për humbjet e pritshme të kredisë.

Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet mbi vlerën kontabël bruto të aktivitet (kur aktivi nuk është me kredit të zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit. Megjithatë, për aktivitet financiare të cilat janë bërë me kredit të zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën e interesit efektiv në koston e amortizuar të aktivitet financiar. Nëse aktivi nuk është më me kredit të zhvlerësuar, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi kthehet në bazë bruto.

Për aktivitet financiare të cilat ishin me kredit të zhvlerësuar në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën e interesit efektiv të kreditit të rregulluar mbi koston e amortizuar të aktivitet. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto edhe nëse rreziku i kreditit të aktivitet përmirësohet. Për informacion se kur një aktiv konsiderohet me kredit të zhvlerësuar, shih shënimin 7(1)(vii).

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(b) Interesi (vazhdim)

Prezantimi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe ATGJ përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të matur me kosto historike, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit.

Politika e aplikuar përpara 1 janar 2019

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektive është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet të përlllogaritura të ardhshme gjatë jetëgjatësisë së pritit të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose, kur është e mundur, një periudhë më e shkurtër) në vlerën aktuale të aktivitetit ose detyrimit. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Fondi vlerëson flukset e ardhshme të parasë duke konsideruar të gjithë termat kontraktual të instrumentave financiarë, përveç humbjeve të ardhshme. Përlllogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat e paguara ose të marra, kosto e transaksionit, dhe zbritjet ose çmimet që janë një pjesë integrale e normës së interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtese të cilat i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së aktivitetit ose detyrimit financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshin interesin të aktiveve dhe detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar e llogarit në bazën e interesit efektiv.

(c) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ndodhin

d) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen në fitim ose humbje pasi ofrohet shërbimi përkatës dhe përfshihet në shpenzimet e personelit.

(ii) Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Fondi paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në një fond që operohet nga shteti shqiptar, që ofron përfitime pensioni, shëndetësore dhe përfitime të tjera sociale për punonjësit. Detyrimet për të tilla kontribute njihen në fitim ose humbje kur ato janë të detyrueshme dhe përfshihen në shpenzimet e personelit. Shteti shqiptar është përgjegjës për përcaktimin e kufirit minimal ligjor për të tilla kontribute.

(iii) Lejet vjetore të paguara

Fondi njuh si një detyrim shumë të pazbritur të koston së përlllogaritur në lidhje me lejet vjetore të cilat priten të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e plotësuar.

e) Shpenzimi për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi fitimin ose humbjen e vitit, dhe çdo sistemim i tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit të pritshëm për tu paguar ose arkëtuar që reflekton pasigurinë që lidhen me tatim fitimin. Ky tatim llogaritet duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose të cilat kanë hyrë në fuqi thelbësisht në datën e raportimit. Aktivitet aktuale tatimore dhe detyrimet mund të kompensohen vetëm nëse kritere të caktuara përmbushen.

7. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

e) Shpenzimi për tatim fitimin (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave përkatëse të përkohshme të tatimit. Nëse shumata e diferencave të përkohshme është e pamjaftueshme për të njohur një aktiv tatim të shtyrë të plotë, atëherë fitime të ardhshme të tatueshme, të rregulluar me anulimet e diferencave ekzistuese të përkohshme, konsiderohen, bazuar në planin e biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor i lidhur me to të realizohet; të tilla reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të ardhshme të tatueshme përmirësohet.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme mund të ekzistojnë ndaj të cilave mund të përdoret. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore të cilat pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato anulohen, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të rezultojnë nga mënyra që Fondi pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbetur të aktiveve dhe detyrimeve.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen vetëm në rast se kriteret e caktuara përmbushen.

f) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet lindin nga shërbimet financiare të ofruara nga Fondi. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi që shërbimet e lidhura janë marrë duke qenë tarifa e administrimit të Fondit. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

g) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

h) Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura me bankat dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Depozitat afatgjata me maturim fillestar më shumë se tre muaj klasifikohen si depozita me afat në banka si nënkategori e huave dhe aktiveve financiare të arkëtueshme.

i) Investime në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë investime borxhi që Fondi ka synimin dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synojnë të mbahen deri në maturim, maten më pas me koston e amortizuar, minus provizioni për zhvlerësim në vlerë. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në blerje.

j) Njësia e investuese dhe konsolidimi

Fondi ka investitorë të shumëfishtë dhe mban investime të shumta. Pasqyrat financiare të Fondit nuk janë të konsoliduara me pasqyrat financiare të Shoqërisë së Administrimit. Fondi konsiderohet të përmbushë përkufizimin e një njësie investuese sipas SNRF 10 si ekzistojnë kushtet e mëposhtme:

(a) Fondi ka marrë fonde me qëllim të sigurimit të investitorëve me shërbime profesionale të administrimit të investimeve.

(b) Qëllimi i biznesit të Fondit, i cili u komunikohet drejtpërdrejtë investitorëve, është investimi për vlerësim të kapitalit dhe të ardhurat nga investimet.

7. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

j) Njësia e investuese dhe konsolidimi

(c) Investimet maten dhe vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë (përveç atyre të klasifikuara si të mbajtura me kosto te amortizuar).

k) Vlera e Aktiveve Neto

Aktivet neto përfaqësojnë kontributet në para dhe kthimin nga investimi në këto kontribute pa pagesat dhe komisionet për Shoqërinë Administruese të kontribuesve të fondit të pensioneve të konvertuara në kuota. Çdo kuotë përfaqëson një pjesë proporcionale të pronësisë mbi çdo pasuri të Fondit. Kuotat i referohen shumës totale të kontributeve të ndara me vlerën e njësisë kontabël.

l) Instrumentet financiarë

(i) Njohja dhe matja fillestare

Fondi njej llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (përfshirë blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën në të cilën Fondi bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit. Një aktiv financiar (përveç nëse është një kërkesë për arkëtim që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi) ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëposhtme

Aktivet Financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me kosto të amortizuar. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit. Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me VDPFH:

- aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale; dhe,
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar gjenerojnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat përbëjnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Fondi vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit.

Informacioni i vlerësuar përfshin:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet kjo performancë drejtimit të Bankës;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si menaxhohen këto rreziqe;
- si kompensohen menaxherët e portofoleve - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset e mjeteve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve për periudhat e kaluara, arsyet e të tilla shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve. Megjithatë, informacioni mbi shitjet nuk merret parasysh i izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm se si arrihen nga Banka objektivat e përcaktuara për menaxhimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset e mjeteve monetare të ardhshme.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(l) Instrumentet financiarë (vazhdim)

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Fondit.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("VPPI")

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Fondi merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Fondi konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Fondit për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme).

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shuma e parapaguar në thelb paraqet shumat e papaguara të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përllogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

Aktivet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet:

Aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar rrjedhimisht maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

Nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar, të matur me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivitetit financiar. Në këtë rast, Fondi rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi (shih 7(c)).

Detyrimet financiare

Fondi çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset monetare të tyre janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar në kushtet e modifikuara. Diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuara njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk njihet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke skontuar flukset monetare të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje

(vi) Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në

7. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(i) Instrumentet financiarë (vazhdim)

një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare normalisht është çmimi i transaksionit – pra vlera e drejtë e shumës së paguar ose të arkëtuar. Nëse Fondi përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nëpërmjet një çmimi të kuotuar në një treg aktiv duke iu referuar një aktivi ose detyrimi identik, dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë ndryshimin midis vlerës së drejtë të njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në periudhat në vijim, kjo diferencë njihet si fitim ose humbje në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlerësimi është i mbështetur plotësisht nga të dhëna të vrojtueshme në treg ose kur transaksioni mbyllet.

Fondi njuh transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Zhvlerësimi

Fondi njuh një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivit, përveç letrave me vlerë për për të cilat llogariten me HPK 12-mujore.

Fondi e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpastia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Fondit pa masa shtrënguese nga ana e Fondit siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si 'Instrumente financiare në Fazën 1'.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Fondi është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Matja e HPK

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhen Fondit në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Fondi pret të marrë).

HPK skontohe duke përdorur normën efektive të aktivit financiar.

Shih shënimin 8.1.

Aktivët financiarë të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Fondi vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë aktive financiare me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet me kredit të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

7. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(l) Instrumentet financiarë (vazhdim)

vlerësuar të aktivitetit financiar. Dëshmia se një aktiv financiar shfaq kredit të zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të vrojtuar:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit;
- mundësinë që debitori të hyjë në falimentim ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; dhe
- zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Në kryerjen e vlerësimit nëse një investim në letra me vlerë është me kredit të zhvlerësuar, Fondi konsideron faktorët e mëposhtëm:

- vlerësimin e tregut për cilësinë e kreditit, siç pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve;
- aftësinë e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri;
- mundësinë e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit, nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit; dhe
- mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes që ekzistojnë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si 'huadhënës i fundit në radhë' për atë vend, si dhe qëllimin e reflektuar në deklaratat publike, të qeverive dhe agjencive të këtyre vendeve për përdorimin e mekanizmave të tillë. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara

Paraqitja e provizionit për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Fondi nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit financiar. Fondi bën një vlerësim individual në lidhje me kohën dhe shumën e fshirjes duke patur parasysh mundësinë e arsyeshme të rikuperimit. Shlyerjet e shumave të fshira më parë janë përfshirë në 'humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare' në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Aktivet financiare që janë fshirë mund të jenë akoma subjekt i veprimeve përmbartimore për të qenë në përputhje me procedurat e Fondit për rikuperimin e shumave të pashlyera.

m) Investime të mbajtura me koston e amortizuar

Investimet përfshijnë letra me vlerë të matura me koston e amortizuar.

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve janë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 janar 2018 dhe zbatimi i hershëm është i lejuar Megjithatë, Fondi për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare nuk ka zbatuar paraprakisht standardet e reja. Standartet që janë relevante për Fondin janë paraqitur më poshtë.

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Fondit:

- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);
- Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19);
- Përmirësimet vjetore të SNRF
- Ndryshimet në referencat e Kornizës Konceptuale të Standarteve SNRF

Përkufizimi i materialitetit – (Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 8)

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë në një sërë rreziqesh financiare: rreziku i tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit me vlerë të drejtë, rrezikun e normës së interesit të fluksit monetar dhe rrezikun e çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Fondi është gjithashtu i ekspozuar ndaj rreziqeve operationale të tilla si rreziku i ruajtjes. Rreziku i ruajtjes është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura të shkaktuara nga falimentimi ose neglizhenca e mbajtësit. Megjithëse ekziston një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura, në rast të dështimit të tij, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të zhvlerësohet përkohësisht.

Programi i përgjithshëm i administrimit të rrezikut të Fondit synon të maksimizojë kthimet për nivelin e rrezikut ndaj të cilit Fondi është i ekspozuar dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të Fondit. Funkzioni i administrimit të rrezikut në kuadër të Fondit kryhet në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operationale dhe rreziqet ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e çmimeve të tjera), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Objektivat primare të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas sigurimi se ekspozimi ndaj rreziqeve qëndron brenda këtyre kufijve. Funksionet e administrimit të rrezikut operational dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore. Fondi nuk përdor instrumente financiare derivative për të mbrojtur ekspozimet e këtyre rreziqeve.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Aktiviteti i Fondit monitorohet dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA. Sh.a (" e Administrimit"). Në pajtim me ligjin nr. 10197 datë 10 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", Shoqëria e Administrimit duhet të krijojë një funksion të veçantë të dedikuar për administrimin e rrezikut. Aksionaret e Shoqërisë Administruese emëruan Këshillin Administrativ të Shoqërisë, i cili përbëhet nga pesë anëtarë:

- Z. Adrian Totokoçi, Kryetar
- Z. Klement Mersini, Anëtar
- Z. Naim Hasa, Anëtar
- Z. Abdyl Sarja, Anëtar
- Z. Edvin Hoxhaj, Anëtar

Kompetencat e Këshillit Administrativ përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi implementimin e politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administrative; aprovimin e politikave financiare dhe investuese; caktimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimit.

Këshilli i administrimit është i angazhuar të sigurojë që Shoqëria Administruese vepron në përputhje me ligjin dhe standardet e kontabilitetit. Këshilli Administrativ caktoi anëtarët e Komitetit Investues si më poshtë:

- Z. Naim Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese.
- Z. Klement Mersini, Drejori Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Z. Blodin Cuci, Drejtor i Alokimit Strategjik të Aseteve në Banken e Shqipërisë
- Znj. Esmeralda Shehaj, Pedagogë e Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik dhe Konsulentë mbi investimet dhe menaxhimin e rrezikut.

Komiteti i Investimit organizon jo më pak se katër mbledhje në vit, në mënyrë që të zhvillojë politika investimi, të kryejë alokimin dhe modifikimin e aktiveve dhe t'ia paraqesë ato Shoqërisë Administruese. Këto politika mbështeten mbi analiza sasiore dhe cilësore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të riskut dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufijtë maksimum të investimit të përcaktuar nga ligji dhe rregulloret e përmendura më lart.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Depozitari

Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", mjetet e fondit të pensionit, duke përfshirë mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, duhet të mbahen me një depozitë të vetme, në një bankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë. Për sigurimin e shërbimeve të mbajtjes siç është miratuar nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare për rolin depozitues.

Shoqëria Administruese e Fondit ka marrëveshje me Bankën Amerikane të Investimeve. Në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", Banka ofron shërbime në lidhje me ruajtjen, depozitimin dhe besimin për aktivet e fondit.

Funksionet e depozitimit përfshijnë llogaritjen e vlerës së aktiveve neto të fondit të pensionit dhe raportimin në baza mujore të Shoqëria Administruese, duke siguruar që të ardhurat nga transaksionet që përfshijnë aktivet e fondit të pensionit shpërndahen/kapitalizohen tek kontribuesit e fondit të pensionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke informuar Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për çdo çështje që mund të përbëjë një shkelje të legjislacionit ose kërcënimin e interesave të anëtarëve.

8.1 Rreziku i tregut

Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhat e huaja, (b) aktivet dhe pasivet që sjellin interesa dhe (c) instrumentet e kapitalit neto, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi përcakton kufijtë mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëria ndaj rreziqeve të tregut paraqitet më poshtë dhe ato bazohen në një ndryshim në një faktor, duke mbajtur të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen

- për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e monedhës së huaj.

a) Rreziku i monedhës

Fondi kryen transaksione në valutë vendore dhe të huaja; prandaj paraqiten ekspozime ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Risku i kursit të këmbimit paraqitet si vlera e transaksioneve të ardhshme dhe aktivet monetare të njohura dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të tjera luhaten për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutë. Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve / detyrimeve. Norma e aplikueshme zyrtare e Bankës (Lek në njësinë e monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishte si më poshtë:

në Lek	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019***(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****8.1 Rreziku i tregut (vazhdim)****a) Rreziku i monedhës**

Aktivët financiarë ose detyrimet financiarë në monedha të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen nga sa më poshtë:

31 dhjetor 2019

Aktivët	në Lek	në EUR	Totali
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	36,831,170	-	36,831,170
Investime në letra me vlerë	1,300,234,498	-	1,300,234,498
Totali i aktiveve financiare	1,337,065,668	-	1,337,065,668
Detyrimet			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(3,350,908)	-	(3,350,908)
Të pagueshme për pensionet e paguara ose tërheqjet e parakohshme	(681,826)	-	(681,826)
Totali i detyrimeve financiare	(4,032,734)	-	(4,032,734)
Pozicioni neto	1,333,032,933	-	1,333,032,934

31 dhjetor 2018

Aktivët	në Lek	në EUR	Totali
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	31,210,135	-	31,210,135
Investime në letra me vlerë	1,300,234,498	-	1,058,365,065
Totali i aktiveve financiare	1,089,575,200	-	1,089,575,200
Detyrimet			
Të pagueshme për pensionet e paguara ose tërheqjet e parakohshme	(3,929,477)	-	(3,929,477)
Totali i detyrimeve financiare	(3,929,477)	-	(3,929,477)
Pozicioni neto	1,085,645,723	-	1,085,645,723

b) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e tij financiar dhe flukset e mjeteve monetare. Periudha për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon në çfarë mase është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018, Fondi nuk ka detyrime të rëndësishme me interes dhe prandaj rreziku i normës së interesit lidhet vetëm me aktivët financiarë me interes.

Çmimet e obligacioneve dhe normat e interesit janë të lidhura anasjelltas. Nga ana tjetër, një mjedis i ulët i normës së interesit e bën të vështirë për Fondin që të sigurojë një normë të mjaftueshme të brendshme të kthimit. Rritja / ulja paralele e kurbës së yield-eve me 100 bp për portofolin e titujve me të ardhura fikse do të rriste / ulte vlerën neto të aktiveve të Fondit për lek 64,685 mijë (2018: 49,691 mijë lek).

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2019
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

8.2 Rreziku i likuiditetit

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	Flukset					
		kontraktuale të paskontuara	Më pak se një muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në një vit	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Aktivët financiarë							
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	36,831,170	36,831,170	36,831,170	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	1,300,234,498	-	-	-	-	50,399,171	1,249,835,327
Totali i aktiveve financiare	1,337,065,668	36,831,170	36,831,170	-	-	50,399,171	1,249,835,327
Detyrimet financiare	(4,032,734)	(4,032,734)	(4,032,734)	-	-	-	-
Hendeku neto i maturimit	1,333,032,933	32,798,436	32,798,436	-	-	50,399,171	1,249,835,327
Efekti i akumuluar			32,798,436	32,798,436	32,798,436	83,197,607	1,333,032,934
31 dhjetor 2018	Vlera kontabël	Flukset					
		kontraktuale të paskontuara	Më pak se një muaj	1 deri në 3 muaj	3 muaj deri në një vit	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Aktivët financiarë							
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	31,210,135	31,210,135	31,210,135	-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	1,058,365,065	1,464,422,952	-	27,318,315	90,039,583	555,516,892	791,548,162
Totali i aktiveve financiare	1,089,575,200	1,495,633,087	31,210,135	27,318,315	90,039,583	555,516,892	791,548,162
Detyrimet financiare	(3,929,477)	(3,929,477)	(3,929,477)	-	-	-	-
Hendeku neto i maturimit	1,085,645,723	1,491,703,610	27,280,658	27,318,315	90,039,583	555,516,892	791,548,162
Efekti i akumuluar							

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2018

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

8.3 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Fondi konsideron këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku individual dhe rreziku i sektorit).

Bordi i Administrimit të Fondit ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut të kredisë te Drejtimi, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bonot e thesarit dhe obligacionet e Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Fondi është e ekspozuar vetëm ndaj rrezikut të kredisë së qeverisë shqiptare.

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal i Fondit ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë.

	Shënimi	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	10	36,831,170	31,210,135
Investime në letra me vlerë	12	1,300,234,498	1,058,365,065
Vlera kontabël		1,337,065,668	1,089,575,200

Politika e investimit

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Vullnetar të Pensionit Sigal bazohet në legjislationin dhe rregulloret e nxjerra nga AMF, si dhe politikat e brendshme të investimit nga ana e Shoqërisë Administruese, të propozuara nga Komiteti i Investimeve dhe të miratuara nga Bordi Drejtues i Shoqërisë Administruese.

Shoqëria administruese është e detyruar të veprojë në përputhje me Rregulloren "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondeve të pensioneve" të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin e Bordit Nr. 1 të datës 28 janar 2010, të ndryshuar me Vendimi i Bordit Nr. 109 i datës 18 tetor 2010.

Bazuar në këtë rregullore, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet në vijim:

- Bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat e tjera me të lëshuara dhe të garantuara nga Qeveria e Shqipërisë;
- Bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë të lëshuara dhe të garantuara nga një shtet anëtar i BE ose OECD ose nga bankat qendrore përkatëse;
- Bonot e thesarit, obligacionet dhe letrat me vlerë të lëshuara dhe të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
- Depozita bankare të licencuara me një maturim më pak se 12 muaj;
- Obligacionet e klasifikuara si BBB ose më të larta sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më të larta sipas Moody's ose BBB (-) ose më të larta sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);

Aksionet ose njësitë e fondeve të investimeve të licencuara në një shtet anëtar të BE dhe objektivi i vetëm i të cilit është investimi në indekset e mëposhtme: CAC 40, DAX, FTSE 100, S & P 500, Mesatarja industriale e Doë Jones, Nikkei 225 (japoneze), Të gjitha Ordinaret (Australian) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacionet, bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tjera të lëshuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2018***(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)***8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)****8.3 Rreziku i kredisë (vazhdim)***Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:*

Cilësia e kredisë së aktiveve financiare është si vijon:

	2019				Total	2018
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI		Total
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	36,831,170	-	-	-	36,831,170	31,210,135
Investime ne letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare B+	1,300,234,498	-	-	-	1,300,234,498	1,058,365,065
Vlera Kontabël	1,337,065,668	-	-	-	1,337,065,668	1,089,575,200

Investimet e letrave me vlerë

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së qeverisë shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare në monedhën vendase në periudhën më të afërt.

Qeveria shqiptare është vlerësuar si B +, e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kredive të Standard & Poor's dhe B1, të qëndrueshëm, bazuar në vlerësimin e kredive të Moody's.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Fondi aplikon një bazë humbjeje 12-mujore dhe reflekton maturitetet afatshkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të saj.

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përllogaritjen e zhvlerësimit

Shiko politikën kontabël në shënimin 7(1)(vii).

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Fondi konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Fondit dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Fondi konsideron që një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, kur një ose më shumë nga kriteret sasiore, cilësore ose kriteret mbështetëse në vijim janë plotësuar.

Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Fondit. Fondi monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë në mungesë.

Përkufizimi i dështimit

Fondi konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Fondit, pa qenë nevoja për veprime nga Fondi të tilla si realizimi i aktive të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose

- debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Fondit.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Fondi konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;

- sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe

- bazuar në të dhënat e zhvilluara së brendshmi dhe të marra nga burime të jashtme.

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

8.3 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 7(1)(v).

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi

nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

- PD-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; me
- PD-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

Matje e HPK

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahet me Bankat tregtare në Shqipëri. Fondi aplikon një bazë humbjeje 12-mujore dhe reflekton maturitetet e shkurtra të ekspozimeve në vlerësimin e zhvlerësimit. Në zbatimin fillestar të SNRF 9, për shkak të ekspozimeve afatshkurtra, Fondi nuk ka njohur një humbje nga zhvlerësimi.

Investimet e letrave me vlerë

Të dhënat kryesore në matjen e HPK janë strukturat kohore të parametrave të mëposhtëm:

- probabiliteti i dështimit (PD);
- humbja nga dështimi (HND);
- ekspozimi në rast dështimi (END).

Vlerësimet e PD janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten në bazë të të dhënave të mbledhura brenda dhe jashtë, që përbëjnë faktorë sasiorë dhe cilësorë. HND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një default dhe vlerësohet bazuar në parametrat e llogaritur nga agjencitë e vlerësimit. END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një default. Fondi nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës duke përfshirë amortizimin. END i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto. Vlerësimet e END janë llogaritur në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës

Fondi mat HPK duke marrë në konsideratë rrezikun e vonesës për periudhën maksimale kontraktuale mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse, për qëllime të administrimit të rrezikut, Fondi konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Fondi ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie.

Më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 Fondi nuk kishte aktive financiare me kredit të zhvlerësuar

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

8.4 Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë që del nga një shumëllojshmëri e shkaqeve të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Fondit, si dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kreditit, tregut dhe likuiditetit të tilla si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullative dhe standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes së korporatave përjashtuar reputacionin dhe rrezikun strategjik.

Qëllimi i Fondit është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia primare për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet Bordit të Administrimit. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Fondit për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- Ndarja e duhur i detyrave, duke përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve
- pajtimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe ligjore
- dokumentimin e kontrolleve dhe procedurave
- Vlerësimi periodik i rreziqeve operationale, përshtatshmëria e kontrolleve dhe procedurave
- Raportimi i humbjeve operationale dhe veprimi i propozuar riparues
- Zhvillimi i planeve të emergjencës
- Trajnimi dhe zhvillimi profesional, standardet etike dhe të biznesit
- zbutjen e riskut, duke përfshirë sigurimin aty ku kjo është efektive.

9. Paraqitja me vlerën e drejtë

Fondi duhet të klasifikojë, për qëllim paraqitjeje, matjet me vlerë të drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që të reflektojë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kuotuar në treg ose çmimet e kuotuar për instrumente financiare të tregtuara në tregje aktive. Për të gjithë instrumentet e tjera financiare, vlera e drejtë përcaktohet me teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika në vlerë aktuale neto, metodën e fluksit të skontuar të parasë, krahasime me instrumente të ngjashme për të cilët ekzistojnë çmime të matshme tregu, dhe modele vlerësimi.

Fondi mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve, që shpjegohet si më poshtë:

Niveli 1: Çmimi i tregut i kuotuar (i pa rregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik.

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të buzara në të dhëna të vrojtueshme, në mënyrë direkte (p.sh. çmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur çmime tregu të kuotura në tregje aktive për instrumente të ngjashme; çmime të kuotuar për instrumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime të kuotuar tregu ose çmime kuotacionesh nga tregtarët. Për instrumente financiare që tregtohen rrallë dhe nuk ka transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon grada të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet e çmimeve dhe risqe të tjera që influencojnë instrumentin specifik.

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2018
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

9. Paraqitja me vlerën e drejtë (vazhdim)

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiarë që nuk maten me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018

	Të mbajtura deri në maturim	Kredi dhe të arkëtueshme	Vlera kontabël	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2019				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	36,831,170	-	36,831,170	36,831,170
Investime në letra me vlerë	1,300,234,498	-	1,300,234,498	1,383,632,993
31 dhjetor 2018				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	31,210,135	-	31,210,135	31,210,135
Investime në letra me vlerë	1,058,365,065	-	1,058,365,065	1,126,249,784

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë gjendjen në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka rezidente. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e drejtë konsiderohet shuma e arkëtueshme në datën e raportimit.

Investime në letra me vlerë

Letrat me vlerë të investimit përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare. Vlera e drejtë për këto letra me vlerë është vlerësuar duke përdorur një model të flukseve të mjeteve monetare të skontuara bazuar në një kurbë korrente të yield-eve të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim.

10. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	36,831,170	31,210,135
<i>në monedhë të huaj</i>	-	-
<i>në lek</i>	36,831,170	31,210,135
Totali	36,831,170	31,210,135

Mjetet në bankë në lekë përfshijnë depozitat afatshkurtra të kryera për periudha të ndryshme midis një dite dhe tre muajsh, në varësi të kërkesave të menjëhershme për mjete monetare të Fondit, dhe fitojnë interes në normat përkatëse të depozitave afatshkurtra.

11. Investime në letra me vlerë

Obligacione Qeveritare	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Vlera e mbetur	1,300,234,498	1,063,582,565
Zhvlerësime në letra me vlere	-	(5,217,500)
Totali	1,300,234,498	1,058,365,065
Ndryshime në zhvlerësimin e letrave me vlerë	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja fillestare	(5,217,500)	-
Zhvlerësimi i vitit	-	(5,217,500)
Rimarrje nga zhvlerësimi	5,217,500	-
Gjendja në fund	-	(5,217,500)

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2018

(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

11. Investime në letra me vlerë (vazhdim)

Investimet në obligacionet e Qeverisë Shqiptare të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim me maturim mesatar prej 7.69 vitesh dhe yield-e duke filluar nga 4.89%-9.52% në vit. (2018: maturimi mesatar prej 7.69 vite dhe yield-e duke filluar nga 4.05% në 9.74% në vit).

Obligacione Qeveritare

31 dhjetor 2019

Data e blerjes	Data e maturimit	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Kuponi	Kostoja e amortizuar më 31 dhjetor 2018
4/Maj/2015	4/May/2020	10,000,000	10,000,000	6.45	10,100,773
8/Nentor/2016	8/Nov/2021	40,000,000	40,000,000	5.25	40,298,399
18/Mars/2013	18/Mar/2020	19,000,000	19,000,000	9.52	19,513,054
13/Qershor/2013	13/Jun/2020	13,000,000	13,000,000	9.12	13,056,105
16/Dhjetor/2013	16/Dec/2020	36,900,000	36,900,000	7.45	37,005,568
17/Mars/2014	17/Mar/2021	12,500,000	12,500,000	7.64	12,774,730
16/Qershor/2014	16/Jun/2021	8,000,000	8,000,000	7.67	8,024,622
15/Shtator/2014	15/Sep/2021	8,700,000	8,700,000	7.77	8,895,641
9/Dhjetor/2014	9/Dec/2021	6,500,000	6,500,000	7.85	6,529,595
16/Qershor/2015	16/Jun/2022	19,800,000	19,800,000	7.8	19,863,184
16/Shtator/2015	16/Sep/2022	18,000,000	18,000,000	7.78	18,402,605
16/Mars/2016	16/Mar/2023	500,000	531,724	4.9	520,541
15/Shtator/2016	15/Sep/2023	22,000,000	22,000,000	4.89	22,312,313
15/Shtator/2016	15/Sep/2023	60,000,000	57,064,435	4.89	58,705,116
1/Qershor/2017	1/Jun/2024	24,000,000	24,000,000	5.39	24,104,301
1/Qershor/2017	1/Jun/2024	42,000,000	40,978,475	5.39	41,422,217
1/Mars/2018	1/Mar/2025	48,000,000	48,000,000	5.86	48,935,394
11/Qershor/2018	11/Jun/2025	65,400,000	65,400,000	5.78	65,604,958
13/Mars/2019	13/Mar/2026	54,000,000	52,995,312	3.75	53,176,860
12/Shtator/2019	12/Sep/2026	55,000,000	55,000,000	4.19	55,691,131
12/Shtator/2019	12/Sep/2026	69,000,000	70,507,799	4.19	70,713,471
15/Korrik/2016	15/Jul/2026	45,700,000	48,048,928	5.8	48,933,941
24/Janar/2014	24/Jan/2024	10,000,000	10,000,000	9.25	10,399,817
25/Prill/2014	25/Apr/2024	7,700,000	7,700,000	9.34	7,829,776
24/Tetor/2014	24/Oct/2024	26,700,000	26,700,000	9.25	27,150,046
23/Janar/2015	23/Jan/2025	32,200,000	32,200,000	9.25	33,494,161
24/Korrik/2015	24/Jul/2025	67,500,000	67,500,000	8.9	70,120,965
23/Tetor/2015	23/Oct/2025	14,500,000	14,500,000	8.8	14,737,227
18/Janar/2016	18/Jan/2026	65,500,000	65,500,000	7.9	67,825,462
15/Korrik/2016	15/Jul/2026	32,000,000	32,000,000	5.8	32,854,637
15/Korrik/2016	15/Jul/2026	59,000,000	61,618,838	5.8	62,346,958
15/Korrik/2016	15/Jul/2026	40,000,000	42,904,943	5.8	42,831,877
7/Tetor/2016	7/Oct/2026	15,800,000	15,800,000	6.7	16,042,331
9/Janar/2017	9/Jan/2027	20,000,000	20,000,000	7.2	20,681,350
9/Janar/2017	9/Jan/2027	11,000,000	11,612,250	7.2	11,558,658
3/Prill/2017	3/Apr/2027	48,700,000	48,700,000	6.45	49,458,842
3/Prill/2017	3/Apr/2027	41,000,000	39,499,484	6.45	40,370,374
11/Janar/2018	11/Jan/2028	32,000,000	32,000,000	7	33,048,690
3/Prill/2018	3/Apr/2028	17,000,000	17,000,000	6.95	17,285,487
		1,274,600,000	1,278,162,189		1,300,234,498

Fondi i Pensionit Vullnetar "SIGAL"
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2018
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)
11. Investime në letra me vlerë (vazhdim)
31 dhjetor 2018

Data e blerjes	Data e maturimit	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Kuponi	Kostoja e amortizuar më 31 dhjetor 2018
8.5.2014	8.5.2019	9,500,000	9,500,000	6.65%	9,593,406
13.8.2014	13.8.2019	14,100,000	14,100,000	6.62%	14,456,938
10.11.2014	10.11.2019	6,000,000	6,000,000	6.62%	6,055,054
4.5.2015	4.5.2020	10,000,000	10,000,000	6.45%	10,101,543
8.11.2016	8.11.2021	40,000,000	40,000,000	5.25%	40,299,664
18.3.2013	18.3.2020	19,000,000	19,000,000	9.52%	19,514,674
13.6.2013	13.6.2020	13,000,000	13,000,000	9.12%	13,057,139
16.12.2013	16.12.2020	36,900,000	36,900,000	7.45%	37,007,920
17.3.2014	17.3.2021	12,500,000	12,500,000	7.64%	12,775,564
16.6.2014	16.6.2021	8,000,000	8,000,000	7.67%	8,025,148
15.9.2014	15.9.2021	8,700,000	8,700,000	7.77%	8,896,233
9.12.2014	9.12.2021	6,500,000	6,500,000	7.85%	6,530,034
16.6.2015	16.6.2022	19,800,000	19,800,000	7.8%	19,864,510
16.9.2015	16.9.2022	18,000,000	18,000,000	7.78%	18,403,831
3.6.2016	16.3.2023	500,000	531,724	4.9%	524,390
15.9.2016	15.9.2023	22,000,000	22,000,000	4.89%	22,312,798
7.12.2016	15.9.2023	60,000,000	57,064,435	4.89%	58,203,913
1.6.2017	1.6.2024	24,000,000	24,000,000	5.39%	24,105,358
6.12.2017	1.6.2024	42,000,000	40,978,475	5.39%	41,277,452
1.3.2018	1.3.2025	48,000,000	48,000,000	5.86%	48,937,736
11.6.2018	11.6.2025	65,400,000	65,400,000	5.78%	65,608,053
24.1.2014	24.1.2024	10,000,000	10,000,000	9.25%	10,400,383
25.4.2014	25.4.2024	7,700,000	7,700,000	9.34%	7,830,424
24.10.2014	24.10.2024	26,700,000	26,700,000	9.25%	27,152,270
23.1.2015	23.1.2025	32,200,000	32,200,000	9.25%	33,496,784
24.7.2015	24.7.2025	67,500,000	67,500,000	8.9%	70,126,242
23.10.2015	23.10.2025	14,500,000	14,500,000	8.8%	14,738,371
18.1.2016	18.1.2026	65,500,000	65,500,000	7.9%	67,829,982
15.7.2016	15.7.2026	32,000,000	32,000,000	5.8%	32,855,783
14.9.2018	15.7.2026	59,000,000	61,618,838	5.8%	62,570,665
5.12.2018	15.7.2026	40,000,000	42,904,943	5.8%	43,056,083
7.10.2016	7.10.2026	15,800,000	15,800,000	6.7%	16,043,008
9.1.2017	9.1.2027	20,000,000	20,000,000	7.2%	20,682,263
4.7.2017	9.1.2027	11,000,000	11,612,250	7.2%	11,578,901
3.4.2017	3.4.2027	48,700,000	48,700,000	6.45%	49,460,840
9.10.2017	3.4.2027	41,000,000	39,499,484	6.45%	40,241,938
11.1.2018	11.1.2028	32,000,000	32,000,000	7%	33,050,105
3.4.2018	3.4.2028	17,000,000	17,000,000	6.95%	17,286,497
6.7.2018	6.7.2028	19,000,000	19,000,000	6.8%	19,629,220
		1,043,500,000	1,044,210,151		1,063,581,116

12. Të ardhura nga interesi i letrave me vlerë

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga bonot e thesarit	76,007,489	66,450,754
Të ardhura nga interesi nga depozitat afatshkurtra	130,284	19,857
Totali	76,137,772	53,463,235

13. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

Ligjore

Në rrjedhën normale të biznesit, Fondi nuk është përfshirë në asnjë proces gjyqësor apo procedure ligjore me 31 Dhjetor 2019.

14. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar ose ushtruar ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër për marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin. Një numër transaksionesh janë të lidhur me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe bilanceve të mbetura në fund të periudhave përkatëse janë si më poshtë:

<i>Vlera neto e mjeteve të kontributeve të punëdhënësit</i>	2019	2018
Punonjësit e Sigal Uniqa Group Austria sh.a.	117,577,399	105,734,399
Tarifat e menaxhimit		
Sh.a.f.p. Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.		
- Paguar	35,896,111	29,543,608
- Detyrime	3,350,908	2,752,473

15. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje pasuese pas datës së raportimit që mund të kërkojnë ose rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

Më 24 mars 2020, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 243, në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përhapjes së virusit COVID19 dhe klasifikimit të tij si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë më 12 mars 2020. Në kuadrin e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit, të miratuara nga akti normativ nr. 8 të datës 24 mars 2020, u pezulluan të gjithë aktivitetet që nuk klasifikoheshin si jetike. Me qëllim vlerësimit e efekteve të mundshme të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, mbi ecurinë e Shoqërisë dhe të fondeve. Shoqëria nuk evidenton asnjë efekt të rëndësishëm, i cili do kërkonte korrigjim ose rregullim të pasqyrave financiare të përgatitura më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.